



UK Shkoder

Ujësjellës Kanalizime Shkodër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR

Nr. 4603 Prot  
Shkodër, më 31.03. 2023

UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A  
SHKODËR

Nr. 603 Prot  
Shkodër, më 31.03. 2023

AKT MARRËVESHJE

E lidhur sot me datën \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023, mes palëve:

*Bashkia Shkodër* - përsaqësuar nga Kryetar i Bashkisë Shkodër Z. Bardh Spahia, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar adresë: Rruga 13 Dhjetori, nr. 1-Shkoder, këtej e tutje e cilësuar si "Bashkia".

*Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a*, përsaqësuar nga drejtori z. Arvit Bushati, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar adresë: Lagjja Nr 3, Rruga "Marin Biçikemi", Shkodër

BAZA LIGJORE:

Kjo akt marrëveshje lidhet në bazë të :

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 'Për sistemin e taksave vendore' të ndryshuar
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar
- VKB nr.73, dt 28.12.2011 "Për përzgjedhjen e Sh.A.Ujësjellës Kanalizime Shkodër si agjent tatimor për pagesen e taksave dhe tarifave te Bashkisë Shkodër për takspaguesit familjar"
- VKB nr.1, datë 22.01.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore", të ndryshuar

*Palët bien dakort sa më poshtë:*

### NENI 1

#### OBJEKTI

Objekt i kësaj akt marrëveshje është kryerja e shërbimit të agjentit tatimor për vjeljen e taksave dhe tarifave familjare të qytetarëve nga ana e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a në gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

### NENI 2

#### QËLLIMI

Qëllimi i kësaj akt marrëveshje është ushtrimi i shërbimit të agjentit tatimor nga ana e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për vjeljen e taksave dhe tarifave familjare nga qytetarët në juridikcion të Bashkisë Shkodër. Akt marrëveshja parashikon llogaritjen, faturimin e detyrimit vjetor të taksës familjare të ndarë në bazë mujore dhe vjeljen e detyrimeve, bazuar në programin informatik të Bashkisë Shkodër SiTTV dhe në programin bazë informatik të klientit të Ujësjellës Kanalizime sh.a Shkodër.

### NENI 3

#### DETYSRIMI QË DO TË LLOGARITET DHE ARKËTOHET

Detyrimet e vitit (referuar nenit 4 të kësaj marrëveshje) për taksat dhe tarifat familjare llogariten nga Drejtoria e të Ardhurave në bazë mujore dhe i dërgohen Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, për t'u përfshirë në faturën e shërbimit të furnizimit me ujë nga Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përsiton përkatesisht 2% (dy përqind) të shumës së arkëtuar.

Taksat dhe tarifat familjare, që arkëtohen nga Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a janë si më poshtë:

1. Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, ku përfshihen:
  - Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat (Ndërtesa banimi).
  - Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore.
  - Të ardhura nga taksa mbi truallin
2. Të ardhura nga tarifat vendore, ku përfshihen:

- Të ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.
- Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik.
- Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin.
- Të ardhura nga tarifa shërbimi AMTP.

#### **NENI 4**

#### **AFATI**

Kjo akt marrëveshje nënshkruhet për një periudhe 01.04.2023 deri me 31.12.2023

#### **NENI 5**

#### **PËRGJEGJËSITË E PALËVE**

- *Bashkia Shkodër merr përsipër :*

Drejtoria e të Ardhurave, në Bashkinë Shkodër, llogarit dhe faturon taksat dhe tarifat familjare të plota dhe me lehtësi fiskale vendore mbi bazë mujore.

I gjithë informacioni më i ri dërgohet me email dhe me shkrim tek Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, deri me datën 25 të muajit, për faturimin e muajit pasardhës.

Bashkia Shkodër i siguron mbështetje Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, sipas kërkesave të kësaj të fundit, në funksion të vjetjes së detyrimeve dhe rritjes së të ardhurave, nëpërmjet strukturave organizative të saj, të Drejtorisë së të Ardhurave, të Njësive Administrative dhe të Policisë Bashkiake.

- *Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, merr përsipër :*

Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, informacionin e marrë nga Bashkia Shkodër, e regjistron në të dhënat bazë të klientit dhe ruan dokumentin original të ndryshimeve mujore, të lëshuar nga Bashkia Shkodër.

Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, kryejnë njostimet për faturimin më i ri për të gjithë abonentët që kanë kontrata shërbimi për ujësjellës, kanalizime dhe klientë familjarë

Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a. mundëson pagesat e taksave dhe tarifave familjare nëpërmjet arkave pranë zonave të banimit në çdo njësie administrative.

Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, transferon vlerat e arkëtuara për taksën e bashkisë çdo muaj në numrat e llogarive përkatëse në Degen e Thesarit në favor të Bashkisë Shkodër, bazuar në saturën për arkëtim që lëshon Bashkia Shkodër. Transferimi i 2%-shit të të ardhurave të arkëtuara për taksën e bashkisë, në cilësinë e agjentit tatimor, do të bëhet kundrejt faturës që do të lëshohet nga Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, bazuar në akt rakordimin e mbajtur.

Transferimet e vlerave mund të bëhen me të shpeshta ose mund të jenë pjesore dhe t'i paraprijnë rakordimeve mujore, por gjithmonë duke u shoqëruar në fund të muajit me proceduren e rakordimit mujor.

## NENI 6

### REGJISTRAT DHE RAKORDIMET

Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, mban përgjegjësi për dokumentacionin dhe regjistrat kontabël e arkivor që nga data e vlefshimërisë së kësaj akt marrëveshjeje. Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, paraqet të dhëna dhe evidencia shkresore dhe elektronike sipas kërkesave të Bashkisë Shkodër në lidhje me të ardhurat, klientet, debitoret etj.

Transferimi elektronik i të dhënave do behet me e-mail mes Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Bashkisë Shkodër në adresat zyrtare.

Çdo muaj ndërmjet Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Drejtorisë së të Ardhurave të Bashkisë Shkodër, realizohet Akt - Rakordimi përkatës, për të ardhurat e arkëtuara gjatë muajit paraardhës. Ky akt-rakordim kryhet deri me datën 15 të çdo muaji, dhe shoqërohet me saturën për arkëtim, që lëshohet nga Bashkia Shkodër.

Për çdo rakordim mujor Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, paraqet bashkangjitur listen e plotë të tatimpaguesve familjare, duke dhënë informacione shtesë mbi numrin e kontratave të reja brenda kësaj liste, si dhe çdo informacion tjetër sipas kërkesës së Bashkisë Shkodër që ka lidhje me të ardhurat nga taksat dhe tarifat familjare.

Transferimi i vlerave të arkëtuara bëhet çdo muaj në numrat e llogarive përkatëse në Degen e Thesarit në favor të Bashkisë Shkodër në përputhje me llogaritë kontabël të faturës për arkëtim. Afati i fundit i transfertës së të ardhurave të vjelura për muajin paraardhës, është data 25 e çdo muaji.

Çdo fillim viti Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, i dorëzon Bashkisë Shkodër listën e plotë të klientëve. Bashkia Shkodër shqyrton listën dhe përditëson informacionin në lidhje me ID e klientit dhe adresën nëse e disponon këtë informacion.

Çdo fund viti Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, i dorëzon Bashkisë Shkodër listën e plotë të klientëve, ku shënohen ato që kanë shlyer detyrimet për taksa dhe tarifa, vlerën që kanë paguar, dhe ata që janë debitorë.

## **NENI 7 FORMAT E BASHKËPUNIMIT**

Bashkëpunimi ndërmjet dy palëve mund të zgjerohet nëpërmjet krijimeve të grupeve të përbashkëta dhe/ose mbështetese, informacioneve të ndërsjellta, ndihmë në logistike etj.

## **NENI 8 MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI**

Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a dhe Bashkia Shkodër zbatojnë masa organizative dhe teknike të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm ose nga humbja, dëmtimi, ndryshimi, aksesi ose përhapja e paautorizuar dhe ndaj çdo forme tjetër përpunimi të paligjshëm si dhe zbaton kërkesat minimale të sigurisë së të dhënavë që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënavë personale dhe aktet nënligjore përkatëse.

Palët garantojnë dhe marrin përsipër se do t'i mbajnë të dhënat e Klientëve në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar dhe në çdo rast, për një periudhë jo më të gjatë se standardet dhe periudhat kohore të këruara. të përcaktuara ose të nënkuptuara nga legjislacioni shqiptar si dhe udhëzimet e nxjerra nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale ("Komisioneri").

Palët duhet të përdorin të dhënat e Taksapaguesve vetëm për qëllime të zbatimit të shërbimeve dhe detyimeve te përcaktuara në këtë Kontratë.

## **NENI 9 PËRFUNDIMI I AKT MARRËVESHJES**

Secila nga palët mund të përfundojë këtë akt marrëveshje në rastet kur:

- Shkelen dispozitat e ligjit dhe të akt marrëveshjes
- Palët nuk i përbahen qëllimit dhe objektit të akt marrëveshjes

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga akt marreveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

### Neni 10

#### **FORÇA MADHORE**

Mospërmbushja e detyrimeve të kësaj Kontrate nga një Palë nuk do të konsiderohet shkelje, apo, mospërmbushje për aq kohë sa kjo mospërmbushje vjen si rezultat i një ngjarjeje të Forçës Madhore, si çdo urdhër, rregullore, vendim qeverie, e shpallur në formën e ligjit apo tjetër forme, ose çdo sanksion kombëtar apo ndërkombëtar, çdo kryengritje, trazira, kryengritje civile, luftë (e dekluar apo jo), veprime apo kërcënime veprimesh nga terroristë ose individë, greva apo trazira të tjera pune, zjarr, përmbytje, termete apo çdo shkak tjetër që nuk varet nga saji apo neglizhenea e njëresh Palë, edhe jo e ngashme me ato të sipërpërmendura, me kusht që një shkak i tillë te mos jetë në kontrollin e arsyeshëm të ndonjëresh Palë. Çdo Palë që pretendon Forçën Madhore, duhet të njoftojë Palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur pasi të ketë ndodhur ngjarja.

### NENI 11

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët, në të kundërt palët kanë të drejtën t'i drejtohen për zgjidhjen e tyre Gjykatës kompetente.

### NENI 12

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Palët përgjigjen reciprocikisht për përbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj akt marreveshje për të qenë partnere në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimitarive.

Në rast të humbjeve monetare, kalimit të afateve pa shkak ose mosrespektimit të elementeve të tjere të kesaj akt marreveshje, ndiqen masat administrative dhe ligjore në fuqi.

Akt marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga palët.

Cdo korrigim i akt marreveshjes pas nënshkrimit të saj e bën atë të pavlefshme.

**NENI 13**  
**HYRJA NË FUQI**

Kjo akt marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët e kësaj marrëveshje.  
Hartohet në 4 kopje të barazylefshme në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë.

**PER**

**BASHKINË SHKODËR**

**KRYETAR**

Bardh SPAHTA



**PER**

**UJESJELLES KANALIZIME SHKODER,SH.A**

**DREJTOR**

Arvit BUSHATI

